



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

*Ministria e Punëve të Jashtme / Ministarstvo Inostranih Poslova / Ministry of  
Foreign Affairs*

**Gambia njih pavarësinë e Kosovës**

Në një takim të veçantë dhe mjaft të frytshëm që ministri Hyseni pati më 26 mars me ambasadorin e Republikës së Gambias në OKB, znj. Susan Waffa-Ogoo, kjo e fundit kishte paralajmëruar dhe njëherazi premtuar njohjen e shpejtë të pavarësisë së Kosovës nga qeveria e vendit të saj. Ky premtim është realizuar dhe Republika e Gambias e ka njohur pavarësinë e Kosovës. Vendimi për njohjen e pavarësisë së Kosovës i është bërë i ditur sot, ambasadës së Kosovës në Uashington nga ambasada e Gambias po në Uashington.

Republika e Gambias është shteti i 57 që e ka njohur Kosovën. Gambia ndodhet në pjesën më perëndimore të Afrikës. Përpos daljes në Oqeanin Atlantik, Gambia është e kufizuar me Senegalin.